

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ Fafa Group” sh.p.k.

Sot, më datë 08/01/2020 , në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

Z. FATOS ÇERENISHTI shtetas shqiptar, lindur në Polican Skrapar më datë 12.01.1970 banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr.H00112088G madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

vendos të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“FAFA GROUP Sh.p.k.**, këtu më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:
Bulevardi Blu Kamez, Zona Kadastrale 8320, nr. pasurie 1/138-ND, Volumi 3, faqe 153
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3

Objekti



3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

Investime,pjesmarrje në fushën industriale turistike, në fushën agroturizëm, duke përfshirë të gjitha operacionet komerciale, ndërtimore,industriale së bashku me shërbimet përkatëse që konsistojnë në investimin, sipërmarrjen, realizimin, blerjen, shëndërrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, shërbimeve përkatëse specifike në konceptimin, krijimin, realizimin dhe zhvillimin e aktivitetit hotelier-turistik, tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakicë, veprimtari në fushën e shit-blerjes si dhe të gjithë formave të qerasë apo të shfrytëzimit të pasurive të patundshme.

Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese hoteleri, bar restorant, me plan shërbim të personalizuar dhe plan shërbim " cdo gjë e përfshirë" (all inclusive), shazllone, stacione plazhi, lundrime turistike,sporte ujore,pistë ne det me lokacion bar restorant, vendbazim për mjete ujore, motorrike dhe jo motorrike, transport organizim i tureve guidave të ndryshme turistike, zhvillimi i panairëve, seminareve dhe work-shopeve ,shërbime opsionale plotësuese me karakter clodhje, pushimi, apo dëfrimi, spektakli, lojëra, organizime dhe realizime "event-sh" të ndryshme, shërbimi spa,shërbim parkimi, si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit të shoqërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 **Leke** (njwqind mije)

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i vetem ,100% ne 1 kuote .

Z.FATOS ÇERENISHTI shtetas shqipatar, lindur ne Polican Skrapar më datë 12.01.1970 banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr. **H00112088G** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;



- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7

Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

Z. Arjol Haxhillari shtetas shqiptar, lindur më Polican Skrapar me date 20.04.1987 banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit nr. **I70420093H** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.



- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8

Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2020.

Neni 9

Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Fatos Çerenishti

Fatos Çerenishti

